



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
**GJYKATA THEMELORE PEJË**  
OSNOVNI SUD PEĆ – BASIC COURT PEJA

---

**P nr.353/16**

**NË EMËR TË POPULLIT**

GJYKATA THEMELORE NË PEJË D.P, gjyqtari Sejdi Blakaj me sekretaren juridike Gjyljeta Çorkadiu , në lëndën penale kundër të pandehurit M.R sipas aktakuzës së PTH-së D.P. në Pejë PP/IL.nr .436/16 të dt.14.4.2016, për shkak të veprës penale: ndryshim i njehsorit të shërbimeve nga neni 323 par 1të KPRK-së, pas përfundimit të shqyrtimit fillestar , publik dhe me gojë, të mbajtur në praninë të pandehurit M.R dhe të prokurorit të shtetit Esad Muharemi me dt.04.4.2017 ka marrë dhe botërisht ka shpallë këtë :

**A K T G J Y K I M**

**I pandehuri M. R i lindur me dt.19.11.1951 në P. rr F. K, i biri Gj dhe nënës Gj e gjinisë D, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës ,gjetet në liri**

**ËSHTË FAJTOR**

Për arsye se:

Që nga data. 07.2.2015 e tutje , në rrugën “F. K” K e P , i pandehuri , me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm të energjisë së shpenzuar , në atë mënyrë që gjatë kontrollit nga ana e komisionit të autorizuar të KEDS –it, është konstatuar se njehsori elektrik pllombat shtetërore i ka të manipuluar , të hapura dhe prapë të mbyllura , në brendi të njehsorit komisioni ka vërejtur se numëruesi i njehsorit është i manipuluar ka gjurmë të gërvishtjes së numrave në numëror , shifra e tretë numër 7, shifra e katërt numër 4, shifra e pestë numër 3.4 në T1, shifra e tretë numë[r 9, shifra e katërt numër 0.9.3, shifra e pestë numër 5,6 në T2, ashtu që në mënyrë të paautorizuar ka shpenzuar energjinë elektrike , me ç’ rast KEDS-it i ka shkaktuar dëm material.

-me çka ka kryer veprë penale : ndryshim i njehsorit të shërbimeve nga neni 323 par 1 të KPRK-së

Prandaj gjykata të pandehurin konform nenit 41, 42,43,46 ,49 ,50,51,52, 76 dhe nenit 323 par 1 të KPRK-së.

**E G J Y K O N :**

1. Me dënim me gjobë në lartësi prej 200 euro , e të cilën gjobë i pandehuri fare nuk do ta paguaj nëse në afat prej 1( një )viti nuk kryen ndonjë veprë tjetër penale .

Dhe :

## **Me dënim burg,**

2. Në atë mënyrë që ia përcakton dënimin me burg në kohëzgjatje prej 4 muajsh , e të cilin dënim i pandehuri fare nuk do ta vuaj nëse në afat prej 1 viti nuk kryen ndonjë vepër tjetër penale

Obligohet i pandehuri që në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 15 euro – 15 ditë pasi që aktgjykimi të merr formën e prerë

E dëmtuara për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest civil.

Shpenzime procedurale nuk ka pasur

## **A r s y e t i m**

Prokuroria Themelore në Pejë me dt.14.4.2016 kundër të pandehurit M.R ka ngritë aktakuzë PP/II. nr.436/16, për vepër penale : ndryshim i njehsorit të shërbimeve nga neni 323 par 1 të KPRK-së, duke i propozuar gjykatës që pas përfundimit të shqyrtimit gjyqësorë të pandehurin ta shpallë fajtorë , ta dënoj sipas ligjit dhe ta obligoj në pagimin e shpenzimeve procedurale .

Në shqyrtimin fillestarë i pandehuri – pasi që paraprakisht i është lexuar aktakuza , është njoftuar me të drejtat dhe detyrimet procedurale dhe pasojat e pranimit përkatësisht të mos pranimit të fajësisë- e ka pranuar fajësinë dhe ka manifestuar keqardhje për atë që i ka ndodhur. Këtë pranim fajësie gjyqtari – pasi që paraprakisht e ka marrë pëlqimin e prokurorit të shtetit, i bindur se pranim fajësinë i pandehuri e ka bërë ashtu siç e parasheh ligji – vullnetarisht dhe pa u ndikuar nga askush dhe në asnjë mënyrë -e ka pranuar .

Meqenëse i pandehuri e pranoj fajësinë gjyqtari kaloi në marrjen e vendimit lidhur me llojin dhe lartësinë e masës ndëshkuese , me ç rast i pati parasysh të gjitha rrethanat rënduese dhe lehtësuese. Rrethanë rënduese në rastin konkret gjyqtari nuk ka gjetur , kurse nga ato lehtësuese ka çmuar : pranimin e sinqertë të fajësisë , pendimin e thellë për këtë gjë, qëndrimin korrekt në gjykatë, pa dënueshmërinë e mëparshme gjendjen e varfër ekonomike i pandehuri është mbajtës i familjes prej 3 anëtarësh , dhe kësaj gjyqtari mendon se edhe me një vendim si në dispozitivin e aktgjyqimit ndaj të pandehurit do të arrihet qëllimi i ndëshkimit i paraparë me neni 41 të KPK-së .

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale dhe të paushallit gjyqësor është marrë konform nenit 450 të KPPRK-së.

Vendimi mbi udhëzimin e të dëmtuarit në kontestin e rregullt civil është marrë konform nenit 463 të KPPRK-së .

Nga sa u tha më lartë konform nenit 365 të KPPRK-së u vendos si më lartë.

Nga Gjykata Themelore në Pejë D.P. datë.04.4.2017

Sekretarja juridike  
Gjyljeta Çorkadiu

Gjyqtari  
Sejdi Blakaj

## **KËSHILLA JURIDIKE**

Kundër këtij aktgjykimi lejohet

Ankesa në afat prej 15 ditësh nga

Dita e marrjes , Gjykatës të Apelit në Prishtinë

E përmes kësaj Gjykate .